

IV. EK.nr.10/18

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË,-DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE me gjyqtarin Murat Paçarada, në çështjen kontestimore të paditësit [“A...”] me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizim e përfaqëson [G.C], kundër të paditurës, Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fitore Byqmeti, për shkak të pasurimit të pa bazë, vlera e kontestit 99.833.92€, pas mbajtje së shqyrtimit kryesor datën 01.05.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET në tërsi kërkesëpadia e paditësit [“A...”] me seli në Prishtinë, ashtu që **DETYPHOHET** e paditura “Komuna e Prishtinës”, me seli në Prishtinë, që në emër të pasurimit të pa bazë t’ia paguaj paditëses shumën prej 99.833.92 € së bashku me kamatën vjetore prej 8%, duke filluar nga data kur është parashtuar padia, gjegjësisht dt.04.01.2018 e deri ne përbushjen e pagesës definitive.

II.DETYPOHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia kompensoj paditëses: taksën për padi vlerën prej 150.00 €, për ekspertizën financiare shumën prej 300.00 €, gjithsej shumën e përgjithshme prej 450.00 €, e të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Rrethanat procedurale të çështjes

Paditësi [“A...”] me seli në Prishtinë, ka paraqitur padi me dt.04.01.2018, kundër të paditurës “Komuna e Prishtinës” për shkak të pasurimit të pa bazë. Paditësi në padinë e tij thekson se me kërkesën nr. ... të dt.29.03.2019,i është drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm të Komunës së Prishtinës, për lejimin e nderimit të kompleksit Ndërtesë Arsimore & Administrative-“B...” në Prishtinë, me etazhitë

Pas pranimit të kërkesës nga paditësi, e paditura me aktvendim e obligon paditësin për pagimin e taksës administrative për leje ndërtimi në shumën prej 52.452.29€, si dhe taksen administrative në shumen prej 99.833.92€, ne emër te tarifës për densitetit infrastrukturore, gjithsejtë në shumen prej 152.286.21€.

Kundër këtij aktvendimi paditësi ka ushtruar ankesë në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikim hapësinor si organ i shkalle se dytë, me te cilën ka këruara qe ta shfuqizoj aktvendimin me nr.05 Nr. ...,të dt.27.04.2017.Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor pas shqyrtimit te ankesës, e shfuqizon aktvendimin e sipër cekur, lenden e kthen ne rishqyrtim dhe rivendosje, më arsyetimin se organi i shkalles se parë nuk ka vendos drejt, më rastin e caktimit të taksës administrative për leje ndërtimi dhe për tarifa për ndikim nga rritia e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013,për [“A...”] sh.p.k, me seli në Prishtinë, e cila tarifë nuk është bërë ne përpjekje me dispozitat e nenit 1 0,parg.2 të Udhëzimit Administrativ nr.22/201 ,Për Taksat Administrative për Leje të Ndërtimit dhe Tarifave për Rregullimin e Infrastrukturës, pasi që caktimi i tarifës për rritudjen e densitetit të infrastrukturës caktohet vetëm për njësit e reja banesore, ndërsa për njësit e tjera, për ndërtimin e objekteve me përbajte afariste.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës, te veproj komfor nenit 9 par.9.1 të Rregullores 01 Nr. ...,datë

24.04.2017,mbi Taksat Administrative për dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës, andaj në këtë rast [“A...”] sh.p.k, të lirohet nga taksa për densitetin infrastrukturore, pasi qe nuk përmban njësi të reja banesore, por është vetëm për afarizëm, administratë, biznes. Shton me pastaj se inkasimi i mjeteve nga Komuna së Prishtinës, në emër të tarifës për dendësi infrastrukturore në shumën prej 99.833.92€,i plotëson kushtet ligjore të pasurimit të pabazë, andaj i propozon gjykatës qe ta obligon palën e paditur qe palës padisë t'ia kthej shumen prej 99.833.92€,me kamat ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në përgjigjen ne padi pala e paditur e konteston si te pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë ,si për nga baza ashtu edhe par nga lartësia, nga se e është i paqëndrueshme pretendimi se e paditura është pasuruar pa bazë, nga shkaku se paditësi vet ka ber kërkesës tek organi kompetent i te paditurës për tu pajasur me leje ndërtimore, të cilën leje ndërtimore organi kompetent ja ka lëshuar palës paditëse. Pala e paditur duke vepruar komfor dispozitave ligjore në procedurë administrative e ka nxjerr aktvendimin me të cilin e ka obliguar paditësen qe të paguaj shumen kontestuese në emër të densitetit infrastrukturor .I propozon gjykatë qe lidhur me ketë çështje te dëgjohen në cilësinë e dëshmitareve arkitekten [N.K], arkitekt [Z.R]. Ne vazhdën i propozon gjykatës qe ta refuzoj në tersi padinë dhe kërkesëpadinë.

Në seancën përgatitore te mbajtur me dt.29.11.2018,përfaqësuesi i palës paditëse deklaron se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i propozojnë gjykatës që e njëjtë të aprovohet si e bazuar. I kundërshtojnë pretendimet e të paditurit si në përgjigje në padi .

Përfaqësuesi i të paditurit deklaron se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi. Në rastin konkret Komuna e Prishtinës, e konteston kompetencën e këtij departamenti, pasi që siç thekson kemi të bëjmë me një aktvendim të organit administrativ , andaj kompetente për zgjidhjen e kësaj lënde është Departamenti Administrativ ashtu siç është e para parë edhe me nenin 17 dhe 26 paragrafi 2.3 të LPK-së, si dhe nenin 46 paragrafi 5,meçë kemi të bëjmë me kërkesën për kthimin e shumës së paguar sipas aktvendimit për leje ndërtimore.

Në replikën e përfaqësuesit të paditësit theksohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasurim të pabazë, për shkak se pala e paditur sipas vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si organ i shkallës së dytë në mënyrë të kundër ligjshme organi i shkallës së parë ka vendosur taksë për dendësi infrastrukturore, e cila taksë lejohet vetëm për njësi banuese, por jo edhe për objektet afariste, dhe si rezultat i kësaj e paditura ka paguar në emër të densitetit shumë prej 99.833.92 €,e që është pasuruar pa bazë juridike.

Në ketë seancë gjykata ka aprovar propozimin e të paditurit që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen [N.K] dhe [Z.R], te punësuar te e paditura. Gjithashtu në ketë seancë gjykata ka aprovar propozimin e pelës paditëse qe te nxirret prova me ekspertizë financiare, ndërsa për ekspert gjykata e ka caktuar [R.F], nga lista eksperteve.

Eksperti finanziar në ekspertizën e dorëzuar gjykatës me dt.18.12.2018,në mendimin dhe konstatimin përfundimtar kolaudon; Duke u bazuar në Aktvendimin e Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës,05 Nr.351/02-0071082/17 dt.27.04.2017,për caktimin e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013,për lejimin e ndërtimit të kompleksit “Ndërtesa Arsimore &Administrative ”B...” në Prishtinë me etazhe ...,ka ber inkasimin e shumes prej 13.30€,për njësi si që është prezantuar në tabelën nr.4 të ekspertizës. Eksperti konstaton se Komuna e Prishtinës ne emër te kësaj takse, nga pala paditëse ka inkasuar shumen prej 99.833.92€.

Në seancën kryesore të datës 18.01.2019, përfaqësuesi i paditësit deklaron se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, nuk ka vrenjtje lidhur me ekspertizën financiare, andaj konsiderojmë se është e plotë dhe profesionale.

Përfaqësuesi i palës se paditur deklaron se e kundërshtojnë ekspertizën e ekspertit në tërësi, pasi qe konsiderojmë se caktimi i taksave është bërë në përputhje të plotë me ligjin, ndërsa eksperti i ka tejkaluar kompetencat kur ka konstatuar se i padituri është pasuruar pa bazë.

Në vazhdimin e seancës kryesore me dt.12.02.2019, në te cilen eshtë ftuar eksperti financiar [R.F], palët ndergjyqëse deklarojn se nuk kanë pyetje per ekspertin, ndërsa gjykata pyet ekspertin se ku jeni bazuar, pasi që në ekspertizën e juaj keni theksuar se "Komuna e Prishtinës" pa të drejtë ja ka marrë ["A..."] taksën në emër të densitetit të infrastrukturës, dhe se lejimi i ndërtimit të kompleksit ndërtimor "B..." në Prishtinë me Etazhe ... me parcelën katastrale ... evidentuar në certifikatën e njësisë kadastralë ... Zona kadastrale Prishtinë.

Lidhur me ketë pyetje eksperti deklaron se konstatimin se pasurimin e pabazë pala e paditur e ka realizuar në shumën prej 99.833,92 €, e kamë bazuar, me Ligjin për financat e pushtetit lokal nr. 03L-049 gjegjësish nenit 17.1 të këtij ligji, si dhe në neni 10 i vlerësimit të tarifave rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës, si dhe duke u bazuar gjithashtu edhe në vendimin me nr. A-156/17, të lëshuar nga Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilin vendim është shfuqizuar Aktvendimi nga Drejtoria e Urbanizmit te Komunës së Prishtinës, 05nr. 351/02 –0071082/17 e dt. 27.04.2017.

Në ketë seancë gjykata ka dëgjuar dëshmitaret [Z.R] dhe [N.K].

Dëshmitari [Z.R], në pyetjet e parashtuar nga palët ndergjyqësve dhe nga gjykata deklaron: Se taksa është caktuar në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal në Prishtinë, për taksa administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013. Ndersa në pyetjen se në bazë të këtij vendimi e behet dallim në mesë të objekteve afariste, dhe objekteve për banim, në raport me atë se si caktohet taksa për densitet, dëshmitari përgjigjet në bazë të këtij vendimi të Kuvendit të Komunës për vitit 2013 nuk ka dallim në taksë të objekteve. Ky dallim përmendet në vendimin e Kuvendit, gjegjësish rregulloren mbi taksën administrative, për dhënet e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës e cila është e vitit 2017. Në pyetjen se me rastin e vendosjes se këtij rasti a keni qenë në dijeni që ekziston një udhëzim administrativ në 22/2012, mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës. Në kohën e marrjes së vendimit vetë Kuvendi Komunale i Prishtinës ka nxjerr rregullore e cila në nenin 9 parashesh përjashtimin, a keni qenë në dijeni për këto dy akte ligjore, dëshmitari përgjigjet po kam qenë në dijeni se ekziston kjo rregullore dhe udhëzimi administrative, mirëpo taksa caktohet në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal. Ndërsa në pyetjen se kur e keni marrë aktvendimin e shkalles së dytë me të cilin është shfuqizuar aktvendimi i dt. 27.04.201, a ju kanë sugjeruar nga Drejtorati i Urbanizmit që të veproni në përputhje me këtë vendim?, dëshmitari përgjigjet nuk na ka thënë as sugjeruar. Në fund të dëshmisë së tij dëshmitari thekson se me profesion është arkitekt, ndërsa vendimin për caktimin e densitetit për ["A..."] e ka përpiluar vet, dhe se nuk është konsultuar me zyrën ligjore të Komunës, për interpretimin e normave juridike te rregulloreve dhe akteve qe i lëshon komuna.

Dëshmitarja [N.K], në pyetjen se në bazë te cilave rregullore, vendimi, udhëzimi administrative, është caktuar tarifa e taksës nga densiteti për infrastrukturë për ["A..."], dëshmitarja përgjigjet se taksa e densitetit është nxjerr në bazë të dy vendimeve të Kuvendi të Komunës së vi tin 2013, si dhe me pëlgimit i cili është marrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në vitin 2013. Ndersa në pyetjen se në bazë të këtyre akteve a bëhet dallimi për caktimin e taksës së densitetit infrastrukturor, në raport me natyrën e objektit, gjegjësish në raport me destinimin e objektit, dëshmitarja përgjigjet se vendimi në

fjalë për caktimin e taksës dhe tarifës së densitetit nuk e ka përjashtua tarifën për densitet të llojut të objektit. Në pyetjen se cili është qëllimi i taksës për densitetit infrastrukturore, dëshmitarja thekson se çështje është e rregulluar sipas vendimit viti 22/2012, ndërsa në pyetjen se a e dini çka thotë nenit 10 i këtij udhëzim administrative, dëshmitarja përgjigjet nuk më kujtohet. Në pyetjen se çka te thotë këshilla juridike kur nuk zbatohet, dëshmitarja thekson se është me profesion arkitekte dhe se gjatë përpilimit të këtij vendimi nuk jemi konsultuar me zyrën ligjore të Komunës. Ndërsa në pyetjen se koha kur Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor e ka shfuqizuar aktvendimin e juaj, a e keni mbledh taksen e densitetit, dëshmitarja thekson se ketë taks nuk e kemi mbledh nga data 16.05.2017, ku edhe jemi njoftuar se rregullorja është në fuqi.

Gjykata për ta vërtetuar bazuaeshmerin e padisë dhe kërkesëpadisë në ketë seancë ka bërë administrimin e provave si në vijim; lexohet vendimi i dt. 12.03.2013, me nr. 01nr. 0..., vendimi i dt. 28.06.2013 me nr. 01.nr. ... i dt. 01.07.2013, ankesa kundër vendimit 05.nr. ... të dt. 27.04.2017, aktvendimi i dt. 27.04.2017 me nr. 05 nr. ... i dt. 27.04.2017, fletëpagesa e dt. 20.04.2017 me nr. ..., vendimi me nr. 05.nr. ... i dt. 02.05.2017, skica e punuar nga drejtoria e urbanizmit e titulluar dispozita urbanistike e objektit me parcelë kadastrës në sistemin koordinator Kosovar F01, komunikim i brendshëm i Ministrisë, shkresa përcjellëse e dt. 23.08.2017 për nxjerrjen e vendimit me nr. nr. A-156/17 dt. 23.08.2017 e nxjerrë nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor në Prishtinë, rregullorja mbi taksen administrative për dhënen e taksës administrative për rregullimin e infrastruktura e dt. 21.04.2017, udhëzimi administrativ me nr. 22/2012 i dt. 19.11.2012, ekspertiza financiare e dt. 18.12.2018 e punuar nga eksperti [R.F].

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, përfaqësuesi i palës paditëse thekson se ka paraqitur kërkesë pran Drejtorisë për Urbanizëm të Komunës se Prishtinës për lejimin e ndërtimit të kompleksit "Ndërtesës Arsimore & Administrative "B..." në Prishtinë E paditura në procedurë të rregullt me aktvendim ka caktuar kompensimin për taksen administrative për leje të ndërtimit dhe tarifat për ndikim nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe atë në shumen prej 52.452.29€, në emër të taksës administrative ,si dhe shumën prej 99.833.92€, në emër të tarifës për densitetin infrastrukturore, gjithsejtë shumën prej 152.265.21€. Paditsi me ankesë ju ka drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si shkallë e dytë. MMPH duke vendosur lidhur me ankesën e ka shfuqizuar aktvendimin e të paditurës, me arsyetim se organi i shkallë së parë nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë për çështjen administrative-juridike, kur ka caktuar taksen për densitet, e cila nuk është ne përputhej me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ nr.22/2012, Për taksat Administrative për Leje të Ndërtimit dhe Tarifave për Rregullimin Infrastrukturës, pasi qe caktimi i tarifave për rritjen e densitetit të Infrastrukturës caktohet vetëm për njësi banuese, ndërsa për njësitë tjera për ndërtimin e objekteve me përbajtje afariste, obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Komuna e Prishtinës të veproj komfor nenit 9 par.9.1 e Rregullores nr.01Nr.016-296053 datë 24.04.2017, mbi taksen Administrative për dhënen e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e Infrastrukturës. Lidhur me ketë rast ["A..."] irohet nga taksa për densitetin infrastrukturore, pasi qe nuk përban nisi të reja banuese, por është vetëm për afarizëm, administratë ,biznes.

Pasi qe e paditura pa kurrfarë baze ligjore është duke i mbajt mjete e palës paditëse i propozon gjykatës qe ta aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ashtu qe ta obligoj palën e paditur t'ia kthej shumen prej 99.833.92€, me kamat vjetore 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet gjyqësore.

Në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim gjykatës, përfaqësuesja e palës së paditur deklarona se duke u bazuar në provat e e parashtruar gjykatës ,padia e paditësit është në tersi e pa bazuar. E paditura Komuna e Prishtinës, duke u bazuar në Vendimin për Taksat Administrative, për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit

të infrastrukturës për vitin 2013 me 01.nr. ... -12.03.2013,Vendimit për Ndryshimet dhe Plotësimet e vendimit për taksen administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimin nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013, ..., datë 01.07.2013,si dhe Pëlqimin e MMPH, për taksen administrative për leje ndërtimi nr....-dt.2207.2013, e ka obliguar palën që në emër të tarifës për densitet infrastrukturor të paguaj shumen prej 99.833.92€.I propozon gjykatës qe padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse ta refuzoj site pabazuar.

Pas administrimit të provave dhe vlersimit me kujdes të tyre , secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Me aktvendimin me nr.05 Nr. ... të dt.27.04.2017,Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës ja ka caktuar taksen administrative [“A...”], për lejen për ndërtim dhe tarifën për ndikim nga rritja e densitetit të Infrastrukturës për vitin 2013,sipas kërkesës nr....,të dt.29.03.2017,në shumen prej 152.286.21€,dhe atë 52.452.29€,taksë administrative, si dhe taksen për densitet infrastrukturor në shumën prej 99.833.92€.

-Sipas flet pagesave me nr.000294,të dt.20.04.2017,pala paditëse ne emër te këtyre taksave e ka paguar shumen prej 152.286.21 €,dhe atë 52.452.29€ në emër të taksës administrative, si dhe shumen prej 99.833.92€,në emër te takse se dentësisë infrastrukturore.

-Me dt.23.08.2017,me vendimin me nr.A-156/17,Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, e ka shfuqizuar Aktvendimin me nr.05Nr.351-02-0071082 datë 27.04.2017,i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, ne te cilin vendim kjo Ministri ka konstatuar se organi i shkallës se parë nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë për çështje administrative –juridike, prandaj organi i shkallës së dytë ,me vendim e kthen lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, pasi qe llogaritja e taksës për densitetës bërrë në kundërshtim me nenin 10 par.2 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2012,Për taksen Administrative për Leje të Ndërtimit dhe Tarifave për Rregullimin e Infrastrukturës, pasi qe caktimi i tarifës për rritjen e densitetit të Infrastrukturës caktohet vetëm për njësi të reja banuese, andaj në ketë rast kërkon qe [“A...”] të lirohet nga taksa për densitetës infrastrukturore ,pasi qe nuk përmban njësi të reja banuese, por është vetëm objekt përafarizëm, administratë dhe biznes.

-Në udhëzimin administrativë me nr.22/2012,nr.protokoli 3276,datë 19.11.2012, nenin 6 pik 1 theksohet “Tarifat Rregullative me ndikim të drejtpërdrejt në Infrastrukturë, duhet të përcaktohen në bazë të rastit, e në pajtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal me Nr.03/L-049,neni 17.1,e që duhet të përcaktohet në bazë të Marrëveshjes për Infrastrukturë në mes aplikantit dhe organit kompetent te përshkruar ne Ligjin mbi ndërtimin me nr.04/L-110,neni 23 dhe nenin 9 i këtij Udhëzimi.

-Ndërsa neni 6.2,theksohet ;”Nëse Komuna vendos të vlerësoj Tarifat rregullative për rritjen densitetit të Infrastrukturës të përdoruar sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049,e përcaktuar ne nenin 17.2.per njësit e reja administrative,” e te cilat duhet të kalkulohen ashtu siç i përcaktuar ky udhëzim administrativ.

-Neni 10 pika 1 ,e po këtij Udhëzimi Administrativ thekson ”Tarifat rregullative për rritjen e densitetit të Infrastrukturës përcaktohen duke pjesëtar territorin e njësive banuese me

numrin e supozuar të anëtareve të secilës njësi banuese një(1)person për 50 m²,shumzuar me tarifën rregullative për rritjen e densitetit të Infrastrukturës për kok banori.

Neni 10.2,thekson”Për konfirmimin e pranimit të aplikacionit nenı 7 pika 2 të Udhëzimit administrativ, organi kompetent duhet të informoj aplikuesin për sasinë dhe metodën e kalkulimit të tarifës rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës, te mbledh tarifën dhe të lëshoj një fature.

-Eksperti finanziar [R.F] në ekspertizën e punuar dhe te dorëzuar gjykatës me dt.19.12.2018,ka konstatuar se [”A...”] si investitor me dt.21.04.2017,ka vepruar sipas Aktvendimit të Drejtoratit të Urbanizmit të Komunës në Prishtinë 05.Nr.351/02-007182/17 dt.27.04.2017 për caktimin e taksës, administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të Infrastrukturës për vitin 2013 dhe llogarinë e Komunës së Prishtinës ...,me nr. Serik të fletëpagesës ...,ka paguar shumën prej 152.287.21€,ndërsa në tabelën nr.4 të kësaj ekspertize e ka precizuar se në emër te taksës së dendësisë infrastrukturore për 7.828.70 m²,me çmim prej 13.30€,ka paguar shumen prej 99.833.92€.

-Gjykata duke i shqyrtuar të gjitha provat së bashku ka konstatuar se Aktvendimi me Nr.351/02-0071082/17 dt.02.05.2017,me te cilin Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës, qe e ka obliguar qe ti paguan ne emër të taksës për densitet infrastrukturor në shumen prej 99.3833.92€, eshtë ne kundërshtim me dispozitat e nenit 10 parg.2 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2012,për taksen Administrative për Lejen e Ndërtimit dhe Tarifave për Rregullimin e Infrastrukturës, pasi qe caktimi i tarifës për rritjen e densitetit të Infrastrukturës caktohet vetëm për njësit e reja banuese, ndërsa kërkesa e [”A...”] sh.p.k, ka të bez me objektet vetëm për afarizëm, administratë dhe biznes. Lirimin nga kjo taksë e përcakton edhe nenı 9.1 e Rregullores me 01-434/01-0094474/17,dt.24.04.2017.”Perjashtimi nga tarifat për ndikim nga rritja te densitetit infrastrukturës.

-Nga ekspertiza financiare e dt.18.12.2018 e punuar nga eksperti [R.F] rezulton se në emër te taksës për densitet te infrastrukturës, Komuna e Prishtinës, ka bërë pasurim pa bazë në shumë prej 99.833.92 €.

Sipas LMD-së, nenı 194,pika 1.thekson”Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dem të në tjetri ,është i detyruar ta kthej atë që ka marr nga tjetëri, ose të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.

Ndersa, pika 3 e po ketij nenı thekson ”Detyrimi për kthim, ose kompensim po ashtu lind edhe nese një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar apo zhdukur”

Gjykata ka shqyrtuar edhe provat tjera të cilat gjenden në shkresatë e lëndës, deklaratat e pales se paditur,si dhe deklaratat e deshmitarve,por të njetave gjykata nuk ja u ka falë besimin, andaj gjykata nuk ka mundur të vendos ndryshe në ketë çeshtje kontestuese

Gjykata duke vendosur për lartësinë e kërkesëpadisë, ia ka fal besimin ekspertizës së ekspertit [R.F], i cili në mendimin e tij profesional theksoi se e paditura Komuna e Prishtinës ka bërë pasurim të pa bazë në vlerë prej 99.833.92€ €, të cilin fakt e ka arsyetuar në detaje në ekspertizën e tij, por edhe në seancën kryesore.


Duke u bazuar në faktet dhe rrëthanat e lartcekura të administruara në këtë procedurë dhe në dispozitat ligjore të cituara më lartë, Gjykata ka ardhur në përfundimin, se paditësi me provat e paraqitura ka arritur të provoj faktet vendimtare të rastit, dhe se kërkesëpadia e tij është e bazuar në ligj, andaj, të njëjtën Gjykata e miratoj si të bazuar.

Shpenzimet procedurale

Neni 449 par.1 dhe 2 të LPK-së është përcaktuar çka përfshijnë shpenzimet procedurale, andaj gjykata ka vendosur edhe për shpenzimet e shkaktuara në procedurë duke u bazuar në nenit 452 par. 1 të LPK-së, ku palës paditëse i janë miratuar, shumat si në vijim: në emër të taksës për padi shuma prej 150,00 €, në emër të ekspertisës financiare shumën prej 300.00€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 450.00€.

Nga te sipër cituarat Gjykata vendosi si në dispozitiv te këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
IV.EK.nr. 10/18, me datën 01.05.2019



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.